



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavuke

ZL.Anr.194/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënim i gjelbër në vlerë prej 3,100.00 (tremijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 12.10.2017, me të cilën pretendon se në tubimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komunën e Artanës duken qartë disa persona që janë nën moshën 18 vjeçare. Sipas tyre personat e mitur vërehen në fotografitë ku shihen disa fëmijë të cilët janë të veshur me fanella të partisë dhe me fotografinë e kandidatit për Kryetar Bajrush Ymeri. Kjo qartazi bie ndesh me Regullën Zgjedhore 13/2013 nen 5.2 që në mënyrë shprehimore ndalon përfshirjen e fëmijëve në fushatë. Gjithashtu sipas tyre takimi është mbajtur në sallën e sportit të shkollës së mesme në Llabjan që është objekt publik dhe kjo bie ndesh me nenin 35.1 të LZP-së. Po ashtu në ankesë kanë kërkuar nga PZAP që me rastin e përcaktimit të lartësisë së gjobës të ketë parasysh si rrëthana rënduese numrin e fëmijëve si dhe faktin se LDK është partia më e vjetër në Kosovë dhe si e tillë duhet të jetë e njoftuar me rregullat zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, si dhe njoftimin përtabin me mbajtura nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, të datës 13.10.2017, theksoi se ankesa është e pabazuar përfaktin se nga fotot e bashkangjitura nuk mundë të vërehen qartë dhe të saktësitet mosha e pjesëmarrësve, dhe se LDK është e kujdeshme në parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në fushatë. Ndërsa sa i përket mbajtjes së tubimit në një sallë të shkollës si "objekt publik" ata konsiderojnë se mbajtja e tubimit nuk bile ndesh me asnjë nga normat e LZP-së e as të rregullave Zgjedhore. Më tej në përgjigje kanë kërkuar nga PZAP-i që një ankesë e tillë ta trajtojë si tendencioze dhe të qëllimshme.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se, nga subjekti politik LDK, është bërë shkelja e Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, subjekti në fjalë ka përdorur fëmijë në spotin e tij, në rrjetin social Facebook, pasiqë nga foto shihen fëmijët me flamuj të subjektit politik në duar, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: "Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet".

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen ka mohuar shkeljen e supozuar. Rrethana këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënim i shqiptuar ndaj subjektit të fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Zl.Anr. 194/2017 më datën 16.10.2017



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par4 të LZP-së.